



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:056973

Datë: 05.03.2024

Numri i dokumentit: 05408617

E.nr.549/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit I.A. nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson av Visar Musa nga Ferizaj, kundër debitorit Spitali i përgjithshëm Ferizaj, për pagesën e pagës jubilarë dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 04.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbarimore në lëndën **E.nr.549/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.549/23, të datës 23.03.2023, e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Spitali i përgjithshëm Ferizaj, për pagesën e pagës jubilarë dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit 2022:056974, të datës 26.01.2023.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 25.07.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 868.94 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e tij, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbarimore në këtë çështje juridike përmbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.549/23, më datë 04.03.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi